



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla ZRRE/Nr. 09/2017

RREGULLA PËR SHKYÇJEN DHE RIKYÇJEN E KONSUMATORËVE NË SEKTORIN E ENERGISË

Prishtinë, mars 2017

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në bazë të kompetencave të dhëna me nenin 9, paragrafi 1.7 dhe nenin 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084 në seancën e mbajtur më 30.03.2017, miratoi:

RREGULLËN PËR SHKYÇJEN DHE RIKYÇJEN E KONSUMATORËVE NË SEKTORIN E ENERGJISË

KREU I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1 Qëllimi

Kjo Rregull përcakton termat, kushtet dhe procedurat në lidhje me shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve në sektorin e energjisë. Rregulla vendos kriteret me anë të të cilave ndërmarrja e energjisë mund të shkyçë dhe rikyçë konsumatorët dhe vendos standarde, parime dhe procedura të aplikueshme në lidhje me shkyçjen dhe rikyçjen në rrjet.

Neni 2 Fushëveprimi

1. Aktivitetet e energjisë që i nënshtrohen shqyrtimit me këtë rregull përfshijnë energjinë elektrike, energjinë termike dhe gazin natyror.
2. Rregulla vendos parime të përgjithshme, në mënyrë që:
 - 1.1. të sigurojë se veprimet e shkyçjes dhe rikyçjes kryhen në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese nga të licencuarit;
 - 1.2. të mbrojnë konsumatorët përmes qasjes transparente dhe të hapur në informacionet që kanë të bëjnë me shkyçjen dhe rikyçjen në rrjet; dhe
 - 1.3. të sigurojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues të të gjithë konsumatorëve në Kosovë, duke respektuar të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me shkyçjen dhe rikyçjen.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **Konsumatorë familjar** – konsumator i energjisë që blen energji për konsum vetanak për ekonominë e vet familjare, duke mos e përfshirë veprimtarinë komerciale apo profesionale. Për objektet që shërbejnë për qëllime fetare aplikohen tarifatat e konsumatorëve familjar.
 - 1.2. **Konsumatorë jo-familjar** – person fizik a juridik që blen energji që nuk e shfrytëzon për nevoja të veta jo-familjare, e ku përfshihen edhe prodhuesit dhe blerësit me shumicë.
 - 1.3. **Konsumator fundor** – konsumatorët që blejnë energji elektrike për përdorim vetanak.
 - 1.4. **Konsumator në nevojë** - konsumator familjar që kualifikohet për mbrojtje apo asistencë sipas rregullave dhe kriterëve të përcaktuara nga Ministria përgjegjëse për mirëqenie

sociale, të përcaktuar në Ligjin për Energji Elektrike dhe Ligjin për Gazin Natyror

- 1.1. **Njoftim paralajmërues** - njoftimi që përmban dispozita sipas Nenit 15 të kësaj rregulle, që një ndërmarrje e energjisë (furnizuesi) i bën konsumatorit, përpara nxjerrjes së njoftimit për shkyçje, duke i dhënë një afat të arsyeshëm për të korrigjuar ose sfiduar arsyet e shkyçjes.
- 1.2. **Njoftim për shkyçje** - njoftim që përmban dispozita sipas Nenit 16 të kësaj rregulle, që një ndërmarrje e energjisë i jep konsumatorit para shkyçjes.
- 1.3. **Shkyçja** - shkyçja e një lidhjeje fizike në mes objektit të konsumatorit dhe një rrjeti të transmisionit apo shpërndarjes që ekzekutohet nga Operatori i Sistemit me kërkesë të Furnizuesit ose për arsyet e sigurisë apo mbrojtjes së aseteve.
- 1.4. **Energjia** - çdo formë e prodhuar e energjisë (energji elektrike, energjia termike ose e gazit natyror) me qëllim të furnizimit ose të shitjes.
- 1.5. **Ndërmarrje e energjisë** - person fizik apo juridik përgjithësisht i organizuar si shoqëri aksionare që kryen një apo më shumë veprimtari të licencuara të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes, furnizimit, tregtimit, tregut të organizuar të energjisë, dhe është përgjegjës për detyrat komerciale, teknike ose të mirëmbajtjes që ndërlidhen me veprimtaritë e cekura, por nuk përfshinë konsumatorin fundor.
- 1.6. **Rrjet** - infrastruktura e nevojshme për transmisionin (bartjen) ose shpërndarjen e energjisë.
- 1.7. **Marrëveshje Paguese** - marrëveshja në mes një konsumatori dhe një furnizuesi, për pagimin e borxhit.
- 1.8. **Furnizues** - ndërmarrje e energjisë e licencuar për të kryer veprimtarinë e furnizimit.
- 1.9. **Zyra e Rregullatorit për Energji – ZRRE (në tekstin e mëtejme Rregullatori)** – është agjenci e pavarur në sektorin e energjisë, e themeluar me ligjin për Rregullatorin e Energjisë;
2. Termat tjerë të përdorur në këtë Rregull kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike, Ligjin për Energjinë Termike, Ligji për Gazin Natyror dhe ligjet e tjera në fuqi në Kosovë.

KREU II PARIMET E PËRGJITHSHME

Neni 4

Parimet e përgjithshme të shkyçjes dhe rikyçjes

1. Çdo ndërmarrje e energjisë duhet të zhvillojë procedura specifike për shkyçje dhe rikyçje, duke i trajtuar konsumatorët në mënyrë transparente dhe jodiskriminuese sipas ligjit përkatës. Procedura e tillë duhet të dërgohet në Rregullator për shqyrtim dhe aprovim. Me këtë Rregull, Operatori i Sistemit bazuar në procedura të veçanta të caktuara nga Rregullatori, kryen veprimin e shkyçjes dhe rikyçjes, shqyrtimin e kyçjeve, dhe veprimin rreth shfrytëzimit të paautorizuar. Të gjitha veprimet e tjera që parashihen në këtë Rregull kryhen nga furnizuesi.

2. Shkyçja është një mundësi që i lejohe ndërmarrjes së energjisë dhe nuk është një kusht që i vihet ndërmarrjes së energjisë prej Rregullatorit. Ndërmarrja e energjisë mund të zgjedhë të vendosë masa më pak kufizuese mbi konsumatorët, sesa ato që dalin nga Rregulla.
3. Ndërmarrja e energjisë duhet të përpiqet të ndërmarrë të gjithë hapat e nevojshëm, përfshirë njoftimin për shkyçje, ose veprime të tjera, të cilat eliminojnë arsyet për shkyçje dhe parandalojnë shkyçjen. Në rast të mospagimit të borxhit, shkyçja duhet përdorur si mjet i fundit para se të kenë dështuar të gjitha masat e vendosura në këtë Rregull dhe Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji.
4. Për sa i përket njoftimit për shkyçje, Rregulla nxjerr kushtet minimale që duhet të përmbushë një ndërmarrje e energjisë. Ndërmarrja e energjisë, sipas vlerësimit të vet, mund të sigurojë njoftim shtesë për të shtyrë periudhën kohore për shkyçje.
5. Rregulla gjithashtu nxjerr kriteret e përgjithshme përmes së cilave ndërmarrja e energjisë i rikyç konsumatorët që i janë nënshtruar shkyçjes. Në këto kritere përshkruhet mënyra e kyçjes pas eliminimit të arsyeve për shkyçje të këtyre konsumatorëve dhe rikyçjes nga ndërmarrja e energjisë sipas afateve të përcaktuara në Nenin 25 të kësaj rregulle.
6. Ndërmarrjet e energjisë ka të drejtë të ngarkojë me taksa konsumatorët për aktivitetin e shkyçjes dhe rikyçjes së tyre, në përputhje me Shtojcën 1: Tabela e taksave për shërbime, e cila aprovohet nga Rregullatori.
7. Ndërmarrja e energjisë obligohet të emërojë dhe t'i certifikojë punëtorët e autorizuar, të cilët bëjnë kyçjen, shkyçjen dhe rikyçjen e konsumatorëve.

KREU III SHKYÇJA KOMERCIALE

Neni 5

Shkyçje për mospagesë të energjisë

1. Ndërmarrja e energjisë mund të shkyçë konsumatorin i cili nuk i përmbahet afatit të pagesës sipas dispozitave të përcaktuara në Rregullën për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, nenit 14, paragrafi 1 dhe nenit 15, paragrafi 1 i kësaj rregulle, apo në kontratën për furnizim.
2. Në rast se konsumatori paraqet prova të qarta të pagesës së faturave ose të këstit ndaj ndërmarrjes së energjisë, sipas marrëveshjes së pagesës, arsye për të cilën është nxjerrë edhe Njoftimi për Shkyçje, atëherë ndërmarrja e energjisë nuk do të shkyçë këtë konsumator.

Neni 6

Shkyçje për arsye të tjera komerciale

1. Një ndërmarrje e energjisë mund të shkyçë një konsumator nëse ai:
 - 1.1. nuk ka paguar një depozitë garancie kur i është kërkuar nga ndërmarrja e energjisë, sipas kushteve të paraqitura në Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
 - 1.2. urdhërohet me vendim gjykate.
2. Ndërmarrja e energjisë ka të drejtë të bëjë shkyçjen e konsumatorëve fundor të cilët:

- 2.1. nuk kanë nënshkruar kontratë me furnizuesin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga pranimi prej konsumatorit të një projekt (draft) kontrate të ofruar për nënshkrim;
- 2.2. janë duke pranuar energji elektrike në mënyrë të paautorizuar, në shkelje të dispozitave përkatëse të Ligjit për Energjinë Elektrike dhe Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Neni 7

Konsumatorët në nevojë

1. Furnizuesi me obligime të shërbimit publik të furnizimit të konsumatorëve fundorë që gëzojnë të drejtën e furnizimit universal, duhet të krijojë mekanizmat e nevojshëm për përkrahjen e konsumatorve në nevojë, pas konsultimit me Rregullatorin, në mënyrë që të shmangen shkyçjes për mospagesë të faturave të energjisë elektrike.
2. Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energji, Ministrinë e Financave dhe në konsultim me Rregullatorin dhe hisedarët tjerë në sektorin e energjisë elektrike, duhet të zhvillojë një program të detajuar për përcaktimin e statusit të konsumatorëve në nevojë, fushëveprimit të të drejtave të tyre, si dhe masave që kanë për qëllim mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë në mbulimin e kërkesës së tyre për energji elektrike.

KREU IV

SHKYÇJA JOKOMERCIALE

Neni 8

Shkyçja për arsye të rreziqeve ndaj shëndetit dhe sigurisë

1. Një ndërmarrje e energjisë është e autorizuar që të shkyçë menjëherë çdo konsumator apo grup të konsumatorëve, në rast se shkyçja është e nevojshme për të larguar ndonjë rrezik ndaj shëndetit dhe sigurisë publike.
2. Kjo lloj shkyçjeje mund të përdoret në rast të ndonjë force madhore ose aksidenti material në instalimet e prodhimit, transmetimit ose shpërndarjes së energjisë, si dhe rreziqe të tjera të mundshme.
3. Menjëherë pas identifikimit të një rreziku për shëndetin ose sigurinë, ndërmarrja e energjisë duhet të përpiqet të njoftojë të gjithë konsumatorët e prekur përpara se të bëjë shkyçjen. Në rast se rreziku është aq urgjent, saqë nuk mund të zbatohet njoftimi, ndërmarrja e energjisë do t'i informojë konsumatorët e prekur sa më parë që të jetë e mundur për shkyçjen dhe do t'u shpjegojë arsyet dhe kohëzgjatjen e mundshme të shkyçjes.
4. Ndërmarrja e energjisë do të bëjë rikyçjen e konsumatorit pa asnjë shpenzim prej tij, menjëherë sapo të ketë bërë adresimin ose largimin e rreziqeve për shëndetin dhe sigurinë me anë të shkyçjes.

Neni 9

Shkyçja për arsye të rrezikimit ose dëmtimit të rrjetit ose pajisjeve

1. Operatorët e sistemit mund të shkyçin objektin e çdo konsumatori apo grupi të konsumatorëve, për shkak të rrezikimit ose dëmtimit të centraleve të energjisë, rrjetit dhe pajisjeve të energjisë

ose njehsorit te energjisë , në përputhje me kodet relevante të nxjerra nga ndërmarrja e energjisë dhe të aprovuara prej Rregullatorit.

2. Operatorët e sistemit do të marrin të gjitha veprimet që të informojnë të gjithë konsumatorët e prekur dhe do të paraqesë arsyet për shkyçjen sipas Nenit 9, paragrafi 1 të kësaj Rregulle. Ky informacion do të sigurohet me shkrim përpara shkyçjes, e nëse kjo është e pamundur, informacioni do të sigurohet menjëherë pas shkyçjes.
3. Informacioni me shkrim do të përmbajë periudhën e shkyçjes së mundshme, e cila duhet të jetë e arsyeshme dhe e bazuar mbi rrethanat e rastit. Nëse shkak i shkyçjes nuk është evituar brenda periudhës së dhënë në informacion, periudha mund të shtyhet deri në përfundim të riparimit. Në rast se është e nevojshme që të shtyhet periudha e shkyçjes për arsye teknike, atëherë konsumatori duhet informuar me shkrim sa më parë që të jetë e mundur.

Neni 10

Shkyçje për shkak të braktisjes

Në rast se ndërmarrja e energjisë identifikon një kyçje që nuk është më në përdorim për shkak të mosbanimit, ose dëmtimit të madh strukturor, që pamundëson banimin e sigurt, atëherë do të dërgojë me postë lajmërimin shkyçës në vendin fizik të kyçjes së objektit në fjalë dhe pastaj të shkyçë objektin.

Neni 11

Shkyçja me kërkesë të konsumatorit

1. Konsumatori ka të drejtë të kërkojë nga ndërmarrja e energjisë shkyçjen e përkohëshme apo të përherëshme të lidhjes së tij nga rrjeti i energjisë-
2. Nëse konsumatori i ka paguar të gjitha detyrimet e tij ndaj ndërmarrjes së energjisë dhe shkyçja është e përherëshme, atëherë taksa për shkyçje nuk do të aplikohet, kurse për shkyçjet e përkohëshme taksat do të aplikohen.
3. Në rast se konsumatori që ka bërë kërkesë për shkyçje të përkohëshme apo të përherëshme dhe nuk i ka paguar plotësisht detyrimet e tij ndaj ndërmarrjes së energjisë, atëherë do të aplikohen dispozitat që kanë të bëjnë me taksat e shkyçjes dhe rikyçjes, siç paraqitet në Shtojcën 1 të kësaj Rregulle-

Neni 12

Shkyçje për arsye të tjera jo komerciale

1. Një ndërmarrje e energjisë mund të shkyçë një konsumator familjar dhe jo familjar nëse ai nuk e lejon përfaqësuesin e autorizuar të ndërmarrjes së energjisë të ketë qasje në pronën apo në objektin e tij: për lexim dhe kontrollim të pikës matëse, funksionimit të pajisjeve dhe kontrollimit për dyshim të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë.
2. Një ndërmarrje e energjisë mund të shkyçë një konsumator komercial apo industrial nëse nuk lejon përfaqësuesin e autorizuar të ndërmarrjes së energjisë të ketë qasje në pronën apo në objektin e tij: për lexim dhe kontrollim pikës matëse, funksionimit të pajisjeve dhe kontrollimit për dyshim të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë.

3. Në rast se konsumatori fundor sipas nenit 39, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3. të Ligjit për Energjinë Elektrike, është furnizuar nga një furnizues i mundësisë së fundit dështon të hyjë në marrëveshje me furnizuesin e ri brenda periudhës së përcaktuar në paragrafin 6 të nenit 39 të ligjit të lartcekur, operatori i sistemit do ta ndërpresë furnizimin me energji elektrike.

KREU V PROCEDURA PËR SHKYÇJE

Neni 13

Njoftimi Paralajmërues për Shkyçje

1. Në rastet e paraqitura në nenin 5, përpara shkyçjes konsumatorit do t'i dërgohet njoftimi paralajmërues në faturë lidhur me borxhin e papaguar. Periudha kohore e njoftimit paralajmërues nuk mund të jetë më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike nga data e fundit e afatit të pagesës.
2. Njoftimi paralajmërues për shkyçje, i cili do t'i dërgohet konsumatorit, do të përmbajë masat që do të ndërmerren ndaj konsumatorit, përfshirë edhe shkyçjen, në rast se ai nuk kryen veprimet e specifikuar në njoftimin paralajmërues brenda afatit të përcaktuar kohor.
3. Njoftimi paralajmërues do të përfshijë edhe të drejtën e konsumatorit për të kundërshtuar shkyçjen dhe afatin përfundimtar për këtë kundërshtim. Ky afat për kundërshtim përcaktohet në Nenin 17 të kësaj Rregulle dhe do të fillojë prej ditës kur dëshmohet se konsumatori e ka marrë njoftimin.

Neni 14

Njoftimi për shkyçje

1. Pas kalimit të afatit përfundimtar të përcaktuar në njoftimin paralajmërues sipas Nenit 14, paragrafi 1, të kësaj Rregulle dhe duke marrë parasysh afatin kohor për zgjidhjen e kontestit të përcaktuar në Nenin 17 të kësaj Rregulle, ndërmarrja e energjisë është e obliguar të dërgojë te konsumatori një njoftim për shkyçje me ose ndaras nga fatura para se të ndërmarrë veprimin për shkyçje për këto raste:
 - 1.1. mospagesën e një fature të energjisë ose kësteve, siç përcaktohet në Nenin 5;
 - 1.2. mospagesën e një depozite garancie të kërkuar nga ndërmarrja e energjisë sipas Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
2. Njoftimi për shkyçje nuk është i domosdoshëm në rrethanat e mëposhtme:
 - 2.1. kur rrezikohet shëndeti dhe siguria e personave, siç përcaktohet në Nenin 8 të kësaj rregulle;
 - 2.2. kur shkyçja behet me kërkesën e konsumatorit;
 - 2.3. në rast të shkyçjes si pasoje e shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë;
3. Në rastet e paraqitura në nenin 12, paragrafi 1 të kësaj Rregulle, ndërmarrja e energjisë përpara shkyçjes duhet të dërgoj te konsumatori njoftimin për shkyçje, ndërsa për rastet e paraqitura në Nenin 12, paragrafi i 2, përpara shkyçjes nuk duhet të lëshohet njoftimi për shkyçje.

4. Për shqycjet që ndërlidhen me paragrafin 2 të këtij neni duhet të bëhet një arsyetim me shkrim, i cili duhet të vendoset në dosjet e konsumatorëve.
5. Pas përfundimit të afatit sipas njoftimit paralajmërues ndërmarrja e energjisë duhet që njoftimin për shqycje t'ia dërgojë konsumatorit të paktën tre (3) ditë kalendarike para datës së shqycje.

Neni 15

Përmbajta e Njoftimit për Shqycje

1. Njoftimi për shqycje i cili dërgohet ndaras nga fatura do të përmbajë të dhënat si vijon:
 - 1.1. emrin e konsumatorit, shifrën e konsumatorit dhe numrin e njehsorit;
 - 1.2. arsyen dhe bazën ligjore për shqycje;
 - 1.3. adresën dhe informacionin kontaktues të zyrës ku konsumatori mund të marrë më shumë informacione dhe/ose të tregojë se janë marrë masat e kërkuara (nëse ka pasur);
 - 1.4. një shpjegim të veprimeve që duhet të ndërmerret konsumatori për të parandaluar shqycjen;
 - 1.5. kushtet dhe procedurat që duhet të përmbushë konsumatori, për të kërkuar rikycjen;
 - 1.6. informatën mbi të drejtën e konsumatorit për të parashtruar ankesë kundër ndërmarrjes së energjisë për të shmangur ose kundërshtuar shqycjen, në pajtim me Rregullën për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë.
2. Njoftimi për shqycje i cili dërgohet në faturën e energjisë elektrike përveç të dhënave në faturë do të përmbajë të dhënat si vijon, borxhin e energjisë së papaguar dhe datën e shqycjes.

Neni 16

Mënyra e dërgimit dhe marrjes së njoftimeve

1. Ndërmarrja e energjisë e cila e dërgon ndaras njoftimin për shqycje, duhet që ta dërgoj:
 - 1.1 personalisht te konsumatori dhe duke kërkuar që konsumatori të nënshkruhet në regjistrin e pranimit të dërgesave.
 - 1.2 nëse konsumatori nuk gjendet në objektin e banimit ndërmarrja e energjisë duhet t'ia len njoftimin për shqycje te adresa e konsumatorit;
 - 1.3 refuzimi eventual i nënshkrimit nga konsumatori duhet të evidentohet në regjistër;

Neni 17

Kundërshtimi dhe shqyrtimi përpara shqycjes

1. Një ndërmarrje e energjisë nuk do ta shqyçë konsumatorin për mospagesë i cili kundërshton në formë të shkruar arsyet për shqycje, përderisa ndërmarrja e energjisë e shqyrton dhe lëshon vendim mbi atë kundërshtim. Nëse konsumatori parashtron ankesë në atë vendim te autoritetet e tjera përgjegjëse, shqycja nuk do të realizohet përderisa ky autoritet nuk shqyrton dhe lëshon vendim mbi atë ankesë.
2. Varësisht nga rrethanat, konsumatorit mund t'i kërkohet të shpjegojë arsyet për ankesën e ngritur dhe të sigurojë ndonjë dokument shtesë të nevojshëm.

3. Nëse objekt i ankesës/kontestit bëhet një faturë, ndërmarrja e energjisë nuk do ta shkyçë konsumatorin në bazë të mospagesës së shumës së plotë të faturës së tillë, derisa ndërmarrja e energjisë dhe/ose Rregullatori ta ketë shqyrtuar dhe të ketë lëshuar një vendim në lidhje me saktësinë e kësaj fature. Derisa të bëhet rishikimi dhe marrja e vendimit, nga konsumatori do të kërkohet të paguajë pjesën e faturës që është e pakontestuar. Pjesa e faturës së pakontestuar do të paguhet bazuar në mesataren e faturave gjatë tre (3) muajve të mëparshëm.

Neni 18

Lehtësimi i përkohshëm për shkak të kushteve të konsumatorit

1. Ndërmarrja e energjisë do të shtyjë veprimin e shkyçjes jo më gjatë se tridhjetë (30) ditë kalendarike, nëse përpara njoftimit për datën e përcaktuar të shkyçjes, konsumatori i siguron ndërmarrjes së energjisë një raport mjekësor të lëshuar nga një mjek i licencuar ose nga një zyrtar i shëndetit publik, ku vërtetohet se shkyçja në shtëpinë/banesën e konsumatorit mund të jetë një kërcënim serioz dhe i menjëhershëm ndaj shëndetit dhe sigurisë së konsumatorit apo anëtarëve të familjes së tij që banojnë në atë shtëpi/banesë.

Neni 19

Shkyçja e ngrohjes gjatë kushteve ekstreme klimatike

1. Nëse me shkyçjen e furnizimit me ngrohje rrezikohet jeta dhe shëndeti i konsumatorëve për arsye të temperaturave të ulëta, atëherë ndërmarrja e energjisë termike nuk do të ndërmarrë veprime të shkyçjes gjatë motit të ftohtë në dimër kur:
 - 1.1. Temperatura më e lartë e ditës paraprake nuk e ka kaluar vlerën -3°C ; dhe/ose
 - 1.2. Raportet meteorologjike parashikojnë se moti do të mbetet në ose më i ulët se -3°C për 24 orët e ardhshme.

Neni 20

Ekzekutimi i shkyçjes

1. Shkyçja e konsumatorëve për mospagesë të faturave për shfrytëzim të energjisë do të kryhet nga punëtorët e autorizuar të ndërmarrjes së energjisë gjatë ditëve të punës, përjashtuar vikendet, një ditë para dhe gjatë ditës së festave zyrtare.
2. Shkyçja për shkak të shfrytëzimit të paautorizuar të energjisë mund të bëhet në çdo kohë nga punëtorët e autorizuar të ndërmarrjes së energjisë.
3. Menjëherë pas kryerjes së një shkyçjeje, punonjësi i ndërmarrjes së energjisë do t'i dorëzojë konsumatorit procesverbalin e shkyçjes së bashku me informacionin konsultativ për hapa të mundshëm që mund të merren nga konsumatorët në mënyrë që të arrihet rikyçja apo iniciimi i ankesës.
4. Në rast se ndërmarrja e energjisë është e penguar fizikisht për të hyrë në objektin ku do të ndodhë shkyçja, ajo mund të kërkojë ndihmë nga organet zyrtare të sigurisë për ta ekzekutuar shkyçjen.

Neni 21

Shkyçja nga Operatori i Sistemit të Transmisionit

Në rast se furnizuesi do të lëshojë urdhër për shkyçje për arsye të mospagesës apo shfrytëzimit të paautorizuar nga konsumatori i cili është i kyçur në rrjetin e transmisionit, atëherë Operatori i

Sistemit të Transmisionit është i obliguar ta iniciojë procedurën për te bërë shkyçjen e konsumatorit te tille, në pajtim me këtë Rregull kodin e rrjetit te Transmisionit përkatës.

Neni 22

Gjuha e njoftimeve dhe e komunikatave

Të gjitha njoftimet për shkyçje, vërejtjet dhe komunikatat e tjera ndaj konsumatorëve, që kanë të bëjnë me shërbimet e ndërmarrjes së energjisë, do të shkruhen në njëërën nga gjuhët zyrtare të cilën e flet konsumatori, në mënyrë të qartë, të shkurtër dhe të kuptueshme.

KREU VI RIKYÇJA

Neni 23

Afatet kohore dhe kushtet për rikyçje

1. Një ndërmarrje e energjisë do ta rikyçë objektin e një konsumatori te shkyçur, jo më vonë se 24 orë pasi të jenë plotësuar kushtet për rikyçje Nëse konsumatori i shkyçur ka parashtruar një ankesë me shkrim në ndërmarrjen e energjisë dhe konteston arsyet për shkyçje, atëherë ndërmarrja e energjisë duhet që në afat sa më të shkurtër kohor, jo më larg se 24 orë nga koha e ekzekutimit të shkyçjes, ta rikyçë konsumatorin.
2. Nëse konsumatori i shkyçur ka kundërshtuar vendimin e ndërmarrjes së energjisë duke kontestuar arsyet për shkyçje te autoritetet e tjera përgjegjëse, atëherë ndërmarrja e energjisë duhet që në afat sa më të shkurtër kohor, jo më larg se 24 orë nga koha e ekzekutimit të shkyçjes, apo kundërshtimit varësisht cila ndodhë e fundit, ta rikyçë konsumatorin deri në një vendim nga autoriteti përgjegjës.
3. Konsumatori i paregjistruar ose konsumatori i cili është shkyçur nga rrjeti ngase është kyçur në rrjet pa pëlqimin e operatorit të sistemit apo furnizuesit të energjisë, do të rikyçet në rrjetet vetëm pasi që t'i ketë plotësuar këto kushte:
 - 3.1. Aplikon për kyçje sipas dispozitave të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji;
 - 3.2. Nënshkruan marrëveshjen për kyçje në pajtim me dispozitat e Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, përfshirë taksat për kyçje;
 - 3.3. Pagan për sasinë e energjisë të konsumuar në mënyrë të paautorizuar, dhe pagesa do të trajtohet në pajtim me dispozitat e Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimi me Energji;
 - 3.4. Nënshkruan kontratën për furnizim me furnizuesin.
4. Konsumatori i paregjistruar nuk do të mund të parashtrojë ankesë në ndërmarrjen e energjisë pa i përmbushur kushtet e paragrafit 3 të këtij Neni.

Neni 24

Refuzimi i rikyçjes

1. Ndërmarrja e energjisë mund të refuzojë të rikyçë konsumatorin, në rast të mospërmbushjes së veprimeve të përcaktuara në nenin 23, paragrafi 3.

2. Refuzimi për furnizim duhet të arsyetohet me shkrim, ku do të përfshihen masat ligjore dhe administrative që janë në dispozicion të konsumatorit nëse kërkon të kundërshtojë këtë vendim.

KREU VII MONITORIMI DHE GJOBAT

Neni 25

Raportimi, monitorimi dhe zbatimi i Rregullës

1. Ndërmarrja e energjisë do të raportojë në Rregullator lidhur me zbatimin e obligimeve që dalin nga kjo Rregull në baza vjetore, si dhe sipas kërkesës së Rregullatorit.
2. Rregullatori do të monitorojë ndërmarrjen e energjisë lidhur me zbatimin e procedurave të shkyçjes të përcaktuara në këtë Rregull. Në rast të konstatimeve të mospërmbushjes së këtyre procedurave nga ana e ndërmarrjes, Rregullatori do të ndërmarrë masa ligjore kundër ndërmarrjes së energjisë.
3. Një ndërmarrje e energjisë duhet të mbajë regjistra për të gjitha shkyçjet dhe rikyçjet dhe duhet t'i ruajë këta për të paktën pesë (5) vjet.

Neni 26

Masat administrative dhe gjobat

1. Rregullatori mund të vendosë gjoba për shkeljen e dispozitave të kësaj rregulle në përputhje me Nenin 57 të Ligjit mbi Rregullatorin e Energjisë dhe Rregullën për Masat Administrative dhe Gjobat.
2. Shuma e gjobave do të përlogaritet në bazë të Rregullës për Masat Administrative dhe Gjobat.

Neni 27

Shqyrtimi i kontesteve

1. Rregulla për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë përcakton procedurat me anë të të cilave konsumatori ose ndërmarrja e energjisë mund të paraqesë në Rregullator një ankesë/kontest lidhur me shkyçjen ose rikyçjen.

KREU VIII DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 28

Ndryshimi

1. Rregullatori mban të drejtën që të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedurat për ndryshim dhe modifikim të kësaj Rregulle, do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 29

Interpretimi

Në rast të paqartësive për dispozitat e kësaj Rregulle, Bordi do të nxjerrë informacione shpjeguese


Neni 30
Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulle shfuqizohet “Rregulla për Shkycjen dhe Rikycjen e Konsumatorëve në Sektorin e Energjisë” (gusht 2011) e nxjerrë sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 03/L-185 .


Neni 31
Hyrja në fuqi

Rregulla hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Rregullatorit, dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.


Bordi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë:



Krenar Bujupi, u.d kryesues



Arsim Janova, anëtar



Besim Sejfiqaj, anëtar

Shtojca 1: Tabela e taksave për shërbime për shkyçje dhe rikyçje

Kategoritë e taksave për shërbimet të cilat duhet t'i paguhen ndërmarrjes së energjisë për shkyçje dhe rikyçje	
1. Shkyçja për konsumatorët shtëpiakë	15.00 €
2. Rikyçja për konsumatorët shtëpiakë	15.00 €
3. Shkyçjet për ekonomitë jofamiljare (konsumatorët komercialë).	30.00 €
4. Rikyçja për ekonomitë jofamiljare (konsumatorët komercialë)	30.00 €